

# BAROMETRI KOMBËTAR I LIRISË SË MEDIAS NË SHQIPËRI

## PËR VITET 2022-2023

**Përgatitja e raportit:**

Z. Vladimir Karaj, Gazetar  
Znj. Ola Mitre, Gazetare

**Rishikim cilësor:**

Z.Niazi Jaho, Këshilltar Ligjor, KShH

**Redaktim ligjor:**

Znj. Erida Skëndaj, Drejtore Ekzekutive,  
KSHH  
Znj. Nosiana Burnazi, Paraligjore dhe  
Asistente Projektsh, KShH

**Publikuar nga:**

Komiteti Shqiptar i Helsinkit  
Rruga “Brigada e VIII”, Kulla  
“Tekno Projekt”, Shkalla 2,  
Apartamenti 10, Kati 6

Dhjetor 2024



© 2024 Komiteti Shqiptar i Helsinkit. Të gjitha të drejtat të rezervuara.

Ky raport u hartua në kuadër të mbështetjes institucionale të ofruar nga Fondacioni Sigrid Rausing Trust..

Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e vetme e Komitetit Shqiptar të Helsinkit (KSHH) dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pikëpamjet e Fondacionit Sigrid Rausing Trust.

**THE  
SIGRID  
RAUSING  
TRUST**

## 1. Hyrje

Në përputhje me misionin e tij për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, KSHH publikon “Barometrin Kombëtar të Lirisë së Medias në Shqipëri” për periudhën 2022-2023.

Barometri përpunon dhe analizon të dhënat e mbledhura nga një sondazh me gazetarë dhe punonjës të medias, duke ofruar një vlerësim sasior dhe cilësor mbi kushtet e tyre të punës, lirinë profesionale dhe perceptimet e tyre mbi lirinë e medias në Shqipëri.

Ky barometër është vijim i dy të ngjashmëve të realizuar në vitet 2020 dhe 2021 për afërsisht të njëjtin kampion të anketuarish.

Liria e medias në Shqipëri mbetet e brishtë, ndërsa media, gazetarët e punonjësit e saj përballen me sfida të rëndësishme, siç theksohet në raportet më të fundit të vlerësimit. Sipas Indeksit Botëror të Lirisë së Medias 2023 nga Reporterët pa Kufij (RSF), Shqipëria renditet në vendin e 96-të nga 180 vende, duke reflektuar një përkeqësim të lirisë së shtypit për shkak të rritjes së presionit politik, kërcënimeve ndaj gazetarëve dhe mungesës së transparencës në pronësinë e medias dhe vështirësive ekonomike<sup>1</sup>.

Raporti i Freedom House 2023 gjithashtu thekson se gazetarët shqiptarë vuajnë nga mungesa e “sigurisë në punë, pagat e ulta dhe janë të ekspozuar ndaj padive, intimidimit dhe herë pas here sulmeve fizike nga ata që përballen me vëmendjen e medias

Raporti mbi pluralizmin në media nga Qendra për Pluralizmin dhe Lirinë e Medias, CMPF, në Institutin Evropian Universitar në Firence për vitin 2023 e vendos Shqipërinë në listën e vendeve me një media në “rrezik të lartë”, sidomos sa i përket përqendrimit të medias në pak duar dhe mungesës së pluralizimit<sup>2</sup>.

Progres raporti i fundit i Komisionit Europian për Shqipërinë për vitin 2023<sup>3</sup>, theksoi se pavarësia dhe pluralizmi i medias vazhduan të ndikohen nga përqendrimi i lartë i tregut, mbivendosja e interesave të biznesit dhe politikës, mungesa e transparencës së burimeve të financimit, përqendrimi i lartë i pronësisë së medias, kërcënimet dhe kushtet e pasigurta të punës për gazetarët .

Nga dy vitet që shqyrtohen në këtë barometër, viti 2023 është në këndvështrimin e lirisë së medias me problematiku<sup>4</sup>, pasi gjatë tij u shënuan incidente të rënda përfshi raste të dhunës fizike ndaj gazetarëve, duke penguar apo dëmtuar misionin e medias për informimin e paanshëm të publikut.

Në fillim të vitit, gazetari Elvis Hila dhe bashkëshortja e tij u sulmuan nga dy persona për shkak të raportimit të tij mbi një vendim gjyqësor. Në një nga rastet e rralla ku vlen të përhëndetet se autorët e dhunës ndaj gazetarëve gjenden dhe dënohen me 4 dhe 5 muaj burg. Por nuk ndodhi e njëjta gjë me sulmin ndaj gazetarëve të emisionit "Fiks Fare" në Fushë-Krujë apo atentatin që i mori jetën një roje sigurie të Top-Channel. Po ashtu të pandëshkuara kaluan edhe kërcënimet apo presionet verbale ndaj gazetarëve Marsi Korreshi, e Syri Tv gjatë fushatës elektorale në Rrogozhinë, apo kërcënimit me jetë të Afrovita Hysaj në Vlorë.

---

<sup>1</sup> <https://rsf.org/en/index?year=2023>

<sup>2</sup> <https://cadmus.eui.eu/handle/1814/76992>

<sup>3</sup> [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/a8eec3f9-b2ec-4cb1-8748-9058854dbc68\\_en?filename=Albania%20Report%202024.pdf](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/a8eec3f9-b2ec-4cb1-8748-9058854dbc68_en?filename=Albania%20Report%202024.pdf)

<sup>4</sup> <https://www.reporter.al/2023/12/27/2023-viti-me-i-keq-per-median/>

Sulmet ndaj gazetarëve nuk kufizohen vetëm në dhunë fizike; ata shpesh shënjestrohen nga politikanë. Gazetarja Ola Xama u sulmua verbalisht dhe ndaj saj pati një fushatë denigruese<sup>5</sup>, për shkak të raportimit të saj mbi aferën e inceneratorëve. Persona me pushtet vijuan sulmet ndaj gazetarëve e medias dhe përdorimin e termave denigrues në të dy vitet në monitorim<sup>67</sup>.

Liria e medias, e garantuar në nenin 23 të Kushtetutës e miratuar në vitin 1998 dhe e mbrojtur nga neni 10 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut që është ratifikuar nga vendi ynë vuan nga simptomat e sulmeve të përhershme prej faktorëve të ndryshëm politikë dhe ekonomikë. Kërkesa të vijueshme nga Bashkimi Europian dhe organizatat për mbrojtjen e lirisë së medias për dekriminalizimin e plotë të shpifjes vijon të mos merret në konsideratë.

Megjithë raportet e shumta për sulme verbale dhe fizike, Shqipëria ende nuk ka krijuar një praktikë të qëndrueshme për ndjekje penale që siguron mbrojtjen e gazetarëve, duke kërkuar kështu një përforsim të kuadrit ligjor dhe rritje të kapaciteteve për zbatimin e ligjit. Kodi Penal gjithashtu nuk përmban dispozita specifike për mbrojtjen e gazetarëve nga dhuna, ndërkohë që transparenca e pronësisë dhe burimeve financiare në media mbetet e kufizuar.

## 2. Përmbledhje ekzekutive

Të dhënat e mbledhura nga anketa tregojnë se gazetaria në Shqipëri, përballet vazhdimisht me presione prej politikës, pushtetit, se shpesh gazetarët ndjehen të censuruar, vetë-censuruar, pambështetur dhe të pasigurtë në punë. Gjithashtu referohen raste të sulmeve fizike e më së shumti verbale si dhe fushatave denigruese, të cilat kanë krijuar një mjedis mediatik tkurrës.

Gjetjet e këtij Barometri nuk ndryshojnë në thelb me çka është konstatuar në dy anketat e mëparshme dhe mungesa e ndryshimit pozitiv është tregues i mungesës së vullnetit, kryesisht nga aktorët në politikë, institucionale dhe biznesi, për të parë një media të lirë dhe cilësore.

Të dhënat prej anketës tregojnë se nuk ka përmirësime të ndjeshme sa i përket trajtimit në vendin e punës, sigurisë financiare apo informalitetit. Problematik mbetet fakti se në vitet 2022 – 2023 ka një rritje me 3.9% të të anketuarve që punojnë pa një kontratë të rregullt pune, që tregon një rritje të informalitetit krahasuar me vitin 2021. Gjithashtu, punëdhënësit në sektor nuk respektojnë kërkesat ligjore të Kodit të Punës, veçanërisht sa i përket raportit midis ditëve të punës dhe atyre të pushimit.

Në disa nga përgjigjet specifike të pyeturit referojnë se një Sindikatë për Gazetarët dhe Punonjësit e Medias është krijuar tashmë, por njohja e saj në radhët e të anketuarve është shumë e ulët. Shumica dërrmuese e të pyeturve e konsiderojnë të domosdoshëm një organizim sindikal të fuqishëm në sektorin e medias, ndërkohë që KShH vlerëson se fuqizimi i kësaj sindikate është i ndërvarur nga nevoja për mbështetje dhe solidaritet më të madh, po ashtu shprehur në terma anëtarësie, nga vetë gazetarët dhe punonjësit e medias.

Në përputhje me strukturën e Barometrit, në vijimësi po paraqesim në mënyrë të përmbledhur të dhënat sasiore dhe cilësore kyç të tij.

- **Liria sindikale**

---

<sup>5</sup> <https://safejournalists.net/portfolios/safe-journalists-netëork-condemns-verbal-attack-of-the-mayor-of-tirana-toëards-ola-xama/>

<sup>6</sup> <https://reporter.al/2024/09/18/berisha-kercenon-gazetaret-per-raportimet-mbi-aktakuzen-e-spak-ndaj-tij/>

<sup>7</sup> <https://reporter.al/2023/04/04/kryeministri-rama-i-akuzon-mediat-si-vater-korrupsioni/>

Të dhënat e anketimit tregojnë se numri i gazetarëve e punonjësve të medias që mendojnë se krijimi i një sindikate është i nevojshëm për të zgjidhur një mori problemesh ka rënë nga barometri i fundit. Nga 202 të anketuar, 89% pohojnë nevojën për krijimin e një sindikate me qëllim mbrojtjen e të drejtave të tyre në punë, kjo shifër ka qenë 97% në barometrin e vitit 2021. Numri i të pyeturve që janë dakord të marrin pjesë në një sindikatë ra në dy vitet e fundit. 29.1 % e të pyeturve u shprehën se nuk do ishin pjesë ose e vunë në dyshim pjesëmarrjen, ky numër në barometrin e fundit ishte vetëm 10.5%.

Në të dy vitet e marra në konsideratë në këtë barometër dhjetra gazetarë humbën vendet e punës dhe në mjaft raste shkarkimet u bënë masive. Televizioni publik shqiptar ishte një prej institucioneve që u denoncua për shkarkime masive nga puna<sup>8</sup>.

- **Informaliteti në punë**

80.7% e të anketuarve pohuan se punojnë bazuar në një kontratë të rregullt pune, ndërkohë që problematik është fakti se numri i punonjësve të medias që deklarojnë se punojnë pa kontratë ka pësuar rritje 3.9% (në total 9.9%), në krahasim me vitin 2021 kur këtë e deklarorin 6% e të anketuarve.

- **Bullizimi/tallja<sup>9</sup> në vendin e punës**

Të dhënat mbi bullizimin dhe/apo talljen në vendin e punës referohen thuhet të njëjta me gjetjet e Barometrit 2021. Rreth 14.5% e të anketuarve pohuan se ishin bullizuar/tallur gjatë punës apo për shkak të saj, në ambientin e punës, një e dhënë që ka pësuar rritje me 2% në raport me vitin 2021. Nga 29 persona që pohuan bullizimin, 6 prej tyre kishin më shumë se 15 vite në punë. Të anketuarit referojnë se autorë të sjelljeve bullizuese apo tallëse janë eprorët e tyre, në nivele të ndryshme duke nisur nga kryeredaktorët, deri te drejtuesit e medias. Në Barometrin 2022 -2023 të anketuarit referuan bullizime edhe nga kolegët<sup>10</sup>.

- **E drejta për pushime javore dhe vjetore**

56.4 %, e të anketuarve deklarojnë se punojnë 6 ditë në javë, me një ulje prej 7.1 % në krahasim me vitin 2021.

11.5% e të anketuarve deklarojnë se nuk bëjnë asnjë ditë pushim, ku pozitive është fakti se ka një ulje me 3% të këtij indikatorit në krahasim me vitin 2021.

Ndërkohë 46% e punonjësve deklaruan se bëjnë më pak pushime vjetore se sa përcakton Kodi i Punës, por megjithatë duke reflektuar një përmirësim prej 20% të respektimit të kësaj të drejte nga Barometri 2021.

37.1% e të pyeturve deklaruan se bëjnë 11-15 ditë pushim në vit, ndërsa 2% e tyre deklaruan se bëjnë 6 - 10 ditë pushime në vit.

- **Kërcënimet për shkak të punës**

---

<sup>8</sup> <https://safejournalists.net/sq/ankesa-per-shkarkim-te-padrejte-ne-radio-televizionin-publik-shqiptar/?lang=sq>

<sup>9</sup> “**Bullizimi**” është përdorimi i forcës, shtrëngimit, ngacmimeve ose kërcënimeve lënduese apo që shkaktojnë dhimbje, me synimin për të abuzuar, dominuar ose frikësuar në mënyrë agresive. Sjellja shpesh përsëritet dhe bëhet e zakonshme. Një parakusht thelbësor është perceptimi (nga ngacmuesi ose nga të tjerët) i një ç’ekuilibri të pushtetit fizik apo shoqëror. Ky ç’ekuilibër e dallon ngacmimin nga konflikti. Burimi për referimin e këtij përkufizimi është marrë nga Juvonen, J.; Graham, S. (2014). "Bullying in Schools: The Power of Bullies and the Plight of Victims". *Annual Review of Psychology*. 65: 159–85.

<sup>10</sup> Një gazetar referoi talljen për shkak se nuk vlerësohen më gazetarët këmbëngulës dhe profesionistë.

Të dhënat e Barometrit për vitet 2022-2023 tregojnë një rënie të kërcënimeve fizike, nga 34.5 % në anketën e vitit 2021 në 20.3% në këtë anketë të fundit.

Po ashtu ka një rënie me mbi 20 % të të anketuarve që deklarojnë se janë kërcënuar apo që u është bërë presion verbal, përkatësisht nga 52.5% e të anketuarve në vitin 2021 në 31.2% në dy vitet 2022 dhe 2023.

Të anketuarit fajësojnë në shumicë politikën sa i përket presioneve verbale, ndërsa është shqetësues fakti se gazetarët raportojnë se iu nënshtruan fushatave denigruese.

- **Stresi dhe situata traumatike**

81.2% e të pyeturve u përgjigjen se kishin përjetuar nivele të larta stresi në punë. Shifra është e ngjashme me nivelet e stresit të raportuara në studime të ngjashme në rajon, megjithatë ka një përmirësim prej 5.8% krahasur me Barometrin 2021.

Një rënie të ngjashme ka edhe sa i përket mbulimit apo raportimit të ngjarjeve me pasojë tronditje të fortë psikologjike. 62.4% e të pyeturve thanë se kishin marrë pjesë në raportime tronditëse, 5.6% më pak se sa në Barometrin 2021. Të dhënat e mbledhura tregojnë se shumica e këtyre raportimeve kanë ndodhur herët në karrierë, por 46% e të pyeturve thanë se kishin raportuar apo mbuluar histori që i kishin tronditur në dy vitet e fundit.

- **Censura dhe vetëcensura**

Nga të dhënat e këtij Barometri rezulton se, numri i rasteve të censurës dhe vetëcensurës në vitet 2022 dhe 2023 ka rënë krahasuar me dy pyetësorët e mëparshëm. Sipas rezultateve, 50.5% e të anketuarve pohuan se janë përballur me censurë, por vetëm 31% (68 persona) raportuan se këto raste kanë ndodhur gjatë viteve 2022-2023, ndërsa të tjerët i referoheshin viteve të mëparshme. Pavarësisht rënies, kjo shifër mbetet e lartë dhe është një barrierë në drejtim të mjedisit të lirë e mundësues të medias në vendin tonë.

Një detaj i rëndësishëm është se ata që përmendin raste censurimi theksojnë se censura është e përsëritur dhe shpesh shërben në favor të një entiteti publik të lidhur me median ku punojnë. Gjithashtu, frika e humbjes së vendit të punës ka një ndikim të madh në mënyrën si raportojnë gazetarët. Kur u kërkua të vlerësojnë këtë ndikim, ku 1 nënkuptonte pa ndikim dhe 5 shumë ndikim, 47.1% e të anketuarve e vlerësuan ndikimin në nivel të lartë, mbi mesataren, përkatësisht nga 3 deri në 5.

- **Vetëvlerësimi i lirisë së medias**

Të dhënat e mbledhura ashtu si në pyetësorët e mëhershëm tregojnë se ndërsa gazetarët e shohin veten e tyre të lirë, mendimi për median dhe lirinë e saj në përgjithësi mbetet mjaft negativ dhe është përkeqësuar ndjeshëm nga Barometrat e viteve 2020 dhe 2021. Të pyetur veç e veç për vitet 2022 dhe 2023 të anketuarit në masën rreth 81 % vlerësuan se media në Shqipëri ishte pak ose aspak e lirë. Në përgjigje të një pyetje me shumë zgjedhje, për të kuptuar se si ishte krijuar perceptimi mbi lirinë e medias shumica dërrmuese e të pyeturve, 71.3% thonë se vlerësimi i tyre vjen kryesisht nga eksperiencia personale.

Shumica e të anketuarve zgjedhën si arsye kryesore për përkeqësimin e lirisë së medias në vend ndërhyrjet dhe interesat e biznesit të lidhur me median. Sipas anketës 78.7% e të pyeturve vlerësojnë këtë faktor si kryesor në mungesën e lirisë së medias në vitet 2022 dhe 2023. Faktori i dytë ndikues rezulton ndërhyrja e qeverisë, e përzgjedhur nga 71.8 % e të anketuarve dhe si arsye e tretë është ndërhyrja e partive politike me 40.1%. Krimi i organizuar dhe bizneset që reklamojnë në zgjedhën si faktorë ndikues nga 28.2% dhe 27.7% e të pyeturve.

- **Gazetaria cilësore**

Krahasimisht me vitin 2021 të anketuarit pohuan se në vend kishte më pak gazetari cilësore. Nga 30% që besonin atëherë se gazetaria cilësore ishte prezentë dhe në rritje, numrat ranë në 19.3% për vitin 2023, ndërsa si vlerësim për vitin 2022 pohimet për prani të gazetarisë cilësore ishin në masën 16.9%.

Ndërkohë, perceptimi se gazetaria cilësore mungonte u rrit nga 30.5% në vitin 2021, në 43.6% në vitin 2022 dhe 39.6% në vitin 2023. Këto të dhëna nuk reflektojnë një trajektore të drejtë me ato të përmendura më sipër, por në tërësi pohojnë trendin se ka një rënie të gazetarisë cilësore për vitet 2022-2023 të marra së bashku.

Në pyetjet e hapura mbi idetë e tyre se si në vend mund të kishte gazetari cilësore, një pjesë e mirë e të pyeturve thonë se shkollimi më i mirë i gazetarëve dhe përgatitja e tyre më e mirë profesionale do të ndikonte pozitivisht.

- **Pengesat për t'iu drejtuar gjykatës kur çënohet liria e shprehjes**

Njësoj si në barometrin e vitit 2021 në shumicë dërrmuese gazetarët thanë se nuk i drejtoheshin gjykatës, për të mbrojtur lirinë atyre apo vendin e punës, për shkak të burokracive. 64.4% e të pyeturve zgjodhën këtë si arsye të parë për mungesë të betejave ligjore. Pjesa tjetër pa ndryshime të mëdha nga viti 2021 thonë se hakamarrja e punëdhënësit, 56.9%, dhe frika se nuk do mund të gjenin punë në një vend tjetër, 57.9%, ishin arsye për të mos iu drejtuar gjykatës.

### **3. Metodologjia**

Të dhënat e Barometrit 2022 – 2023 janë marrë duke përdorur metodën e sondazhit, i cili është realizuar me anë të një pyetësi elektronik, i cili përbëhej nga 67 pyetje (të mbyllura dhe/ose të hapura), të hartuar nga ekspertë të medias dhe të rishikuar më pas nga KSHH. Metodologjia e mbledhjes së të dhënave është e njëjtë me Barometrin e vitit 2021. Ndërkohë që, duke marrë në konsideratë se ky Barometër përfshin mbledhjen e të dhënave për 2 vite kalendarike, pyetësit iu shtuan disa pyetje specifike mbi periudhën e shkeljeve të mundshme në punë, të raportuara nga punonjësit e medias. Kjo për të përmirësuar cilësinë e të dhënave të grumbulluara, por në të njëjtën kohë duke garantuar mbledhjen e të dhënave të njëjta dhe një krahasim të saktë të të dhënave ndër vite.

Si kufizim metodologjik i Barometrit mund të përmendet bazueshmëria e tij në të dhënat sasiore dhe cilësore që kanë rezultuar nga perceptimet e të anketuarve si dhe referimi në raporte dhe artikuj të ndryshëm, përfshi këtu të organizatave ndërkombëtare si Raporterët Pa Kufij, Freedom House, Komisioni Evropian, etj. Në këtë Barometër nuk janë analizuar të dhëna të disponuara nga organet ligjzbatuese, gjyqësori apo Institucionet e Pavarura në vendin tonë, pasi në të kaluarën, KSHH ka ndeshur në vështirësi në marrjen dhe përpunimin e të dhënave të kategorizuara mbi proceset me palë ndërgjyqëse apo viktime, punonjësit e medias.

Për realizimin e sondazhit, dy ekspertë të medias kontaktuan në rrugë elektronike dhe telefonike, përkatësisht rreth 400 punonjës të medias (gazetarë, kryeredaktorë, redaktorë, regjisorë, operatorë, montazhierë, etj.), praktikë e ndjekur edhe në Barometrat paraardhës. Interesit për Barometrin i janë përgjigjur 202 punonjës të sektorit të medias. Pyetësi është ndarë me të anketuarit në format elektronik, çka i ka mundësuar të interesuarve ta plotësojnë në mënyrë të pavarur, të pandikuar dhe në mënyrë anonime. Sigurimi i anonimatit u vlerësua nga ekspertët e medias se nxiti një nivel më lartë të reagimit pozitiv për t'iu përgjigjur Barometrit, pasi të anketuarit do të ndiheshin të lirë dhe jo të paragjykuar për përgjigjet e dhëna. Pas mbledhjes së të dhënave, përgjigjet për pyetjet e mbyllur janë përpunuar në formën statistikore,

ndërkohë që përgjigjet e hapura, janë analizuar nga pikëpamja cilësore nga ekspertët e angazhuar për zbatimin e Barometrit. Gjithashtu, përgjatë analizës në Barometrin 2022 - 2023, është përdorur edhe metoda krahasimore me të dhënat e vitit 2021, për të gjurmuar ndryshimet në situatën e lirisë së medias.

Vlen të theksohet se, kampioni i përzgjedhur, pavarësisht se është i konsiderueshëm nuk mund të krahasohet objektivisht me numrin total të punonjësve të sektorit të medias në vendin tonë. Aktualisht mungojnë të dhëna të sakta lidhur me këtë tregues.

Referuar të dhënave të mbledhura më herët nga ekspertë të fushës dhe organizata të shoqërisë civile, përlllogarit se numri i punonjësve të medias varion mes 6200 dhe 5900 persona<sup>11</sup>. Të dhënat e rrjedhura në vitin 2022 nga databaza e pagave për vitin 2021 jepnin një numër edhe më të ulët të punonjësve në media. Sipas kësaj databaze në media të ndryshme kishte rreth 2500 punonjës. Mbyllja e njëpasnjëshme e një sërë publikimesh të shtypura dhe ulja e tirazheve ka sjellë rënie të numrit të punonjësve në këtë sektor. Mungesa e transparencës sa i përket punonjësve në media lidhet me informalitetin e përhapur gjërësisht edhe nga të anketuarit në këtë barometër. Ky informalitet sjellë një sërë shqetësimesh, përfshi pasigurinë për vendin e punës<sup>12</sup>, trajtim jo të drejtë financiar në rast sëmundjesh apo pamundësie dhe drejtpërdrejt ndikon në pavarësinë e punonjësve të medias, sidomos gazetarëve.

Metodologjia e kampionimit ka si qëllim gjithë përfshirjen e gazetarëve dhe punonjësve të medias, duke marrë në konsideratë elemente si gjinia dhe shpërndarja gjeografike, ku të anketuarit ishin të pozicionuar në qytetet e Tiranës, Gjirokastrës, Vlorës, Fierit, Shkodrës, Elbasanit, Durrësit, Lezhës, Dibrës dhe Librazhdit. Për shkak të natyrës së pyetjeve, një numër shumë i lartë i përgjigjeve ka ardhur nga gazetarë, kryeredaktorë, redaktorë dhe drejtor informacioni (rreth 80%), ndërkohë që i janë përgjigjur në minorancë, punonjës të tjerë të sektorit të medias (Regjisor, montazhier, kameramanë, teknikë transmetimi, etj.). Lidhur me mediat ku të anketuarit janë të punësuar, të parët më të përfaqësuar në të dhënat që Barometri janë punonjësit e televizioneve, ndjekur nga punonjësit e portaleve online, kjo edhe për shkak të rënies së numrit të gazetave dhe revistave. Në Barometrin e vitit 2022 - 2023 kjo diferencë është thelluar edhe më tepër, ndërkohë që vihet re përgjatë këtyre 2 viteve vihet re një rritje e numrit të të punësuarve në media OJF, që tashmë zënë thuajse të njëjtën peshë me shtypin e shkruar.

Sondazhi u realizua gjatë periudhës gusht – shtator 2024, por të dhënat e tij i referohen periudhës 2022 - 2023. Pyetjet janë organizuar në 3 blloqe të ndryshme.

- **Blloku i parë i pyetjeve** mundëson mbledhjen e të dhënave konkrete mbi kushtet dhe respektimin e të drejtave të gazetarëve në vendin e punës. Ky bllok paraqet të dhëna mbi marrëdhënien kontraktuale në punë, kohëzgjatjen e kontratës, pushimet javore dhe ato vjetore, si dhe mbi nevojën për ngritjen e një sindikate për të mbrojtur të drejtat e tyre në punë.
- **Blloku i dytë i pyetjeve** mundëson mbledhjen e të dhënave mbi situatën dhe faktorët që ndikojnë në lirinë profesionale të punonjësve të medias. Këtu përfshihen edhe faktorë si kërcënimet gjatë ushtrimit të profesionit, stresi apo tronditjet psikologjike si pasojë e punës apo ndikimi që kanë punëdhënësit/redaktorët në transmetimin e ngjarjeve.
- **Blloku i tretë i pyetjeve** përmban pyetje për mbledhjen e të dhënave mbi faktorët që sipas punonjësve të sektorit ndikojnë në lirinë e medias, si dhe sugjerimet e tyre mbi masat që do të ndihmonin më shumë rritjen e lirisë së medias.

<sup>11</sup> [https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2020/06/Raport-Studimor\\_Te-drejta-pune-per-gazetaret\\_ALB-1.pdf](https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2020/06/Raport-Studimor_Te-drejta-pune-per-gazetaret_ALB-1.pdf)

<sup>12</sup> [https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2023/01/Policy-paper\\_Sfidat-e-gazetareve-dhe-liria-e-medias-ne-Shqiperi-2.pdf](https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2023/01/Policy-paper_Sfidat-e-gazetareve-dhe-liria-e-medias-ne-Shqiperi-2.pdf)




## Të dhëna të përgjithshme për të anketuarit

Të dhënat e kategorizuara për personat që i janë përgjigjur Barometrit, pasqyrohen në vijimësi:

### a) Gjinia

96 e të anketuarve apo 47.5% e tyre ishin femra, ndërsa 106 apo 52.5% e totalit ishin meshkuj.

Gjinia  
202 responses




### b) Moshë

Të dhënat e kategorizuara sipas moshës së të anketuarve evidentojnë se:

- 24.8% e tyre i përkisnin grupmoshës 20-30 vjeç,
- 43.6% bënin pjesë në grupmoshën 31-40 vjeç,
- 25.7% i përkisnin grupmoshës 41-50 vjeç.
- në grupmoshën 51-60 vjeç bënin pjesë 5.9% e të anketuarve

Moshë  
202 responses



### c) Përvoja në sektorin e medias


Shumica e të anketuarve rezultojnë me përvojë në sektorin e medias. 62.8% e atyre që i janë përgjigjur Barometrit, referojnë se kanë mbi 10 vjet që ushtrojnë profesionin. Në krahasim me Barometrin 2021, përvoja e të anketuarve ruan thajse të njëjtën strukturë, me një rënie prej rreth 3% të viteve të përvojës në punë në Barometrin 2022-2023 dhe me një rritje prej gati 11% të të anketuarve me përvojë pune mesatare 5 - 10 vjet. Disa prej të dhënave lidhur me përvojën rezultojnë si vijon:

- Më shumë se 1/3 e tyre apo 35.6% referojnë se kishin mbi 15 vjet përvojë.
- 27.2% e të anketuarve kishin 10-15 vjet përvojë
- 24.3% e të anketuarve kishin 5-10 vjet përvojë,

- 10.4% kanë 1-5 vjet përvojë,
- ndërkohë që 2.5% e totalit kishin më pak se një vit që punojnë në sektorin e medias.

#### Vitet e eksperiencës në gazetari

202 responses



#### d) Pozicioni

Në sondazh u përfshinë punonjës të medias që ushtrojnë profesionin në pozicione të ndryshme. Në Barometrin 2022 -2023 të anketuarit që u vetëdeklaruan gazetarë, kryeredaktorë, redaktorë dhe drejtor informacioni përbëjnë gati 80% të të anketuarve. Kjo e dhënë nënkategorizohet si vijon. Rreth 57% e tyre u vetëdeklaruan gazetarë, 7.9% kryeredaktorë, 13.4% redaktorë dhe 1.5% drejtorë informacioni. Pjesa tjetër, prej rreth 20% përfshinin punonjës në pozicione të tjera, si: Regjisorë, montazhierë, kameramanë, teknikë transmetimi, etj.

#### e) Shpërndarja gjeografike

Puna në kryeqytet dominon me 87.5% e të anketuarve të cilët pohojnë se punojnë në Tiranë, duke reflektuar një rritje me 5% të këtij idikator në krahasim me vitin 2021, ndërsa 12.5 % e tyre referuan se punonin në qytete të tjera të vendit, sikurse janë: Korça, Fieri, Elbasani, Durrësi, Shkodra, Lezha, Dibra, etj.

#### f) Kategorizimi i medias

Me qëllim gjithëpërfshirjen e punonjësve të mediave, Barometri u shtri në të gjithë territorin e vendit, duke përfshirë punonjës të mediave lokale, kombëtare, rajonale dhe atyre ndërkombëtare. Ky kategorizim nuk reflekton domosdoshmërisht vendndodhjen gjeografike të të anketuarve, por llojin e medias për të cilën ata punojnë. Angazhimi i të anketuarve në Barometrin 2022 – 2023, sipas shtrirjes gjeografike së medias ruan thuhet të njëjtën strukturë me atë të vitit 2021. Konkretisht, 80 % e të anketuarve pohuan se ishin të punësuar apo angazhuar më mediat kombëtare, 10 % në mediat lokale, 5.5% në mediat rajonale dhe 4.5% në mediat ndërkombëtare. Një rritje me 3 % ka pësuar edhe angazhimi me mediat rajonale, e për pasojë evidentohet në radhët e kampionit të të anketuarve, ulje e punësimit apo angazhimit me mediat lokale me 3 %.


79.7% e të anketuarve evidentohet se janë të punësuar apo të angazhuar në një prej televizioneve në vend, por gjithsesi duke reflektuar në kampionin e të anketuarve një rënie me 5.7 % nga viti 2021. 9.5% e të anketuarve punonin në portale online, ndërkohë që 6.5% e të anketuarve punonin në median e shkruar (përkatesisht 6% në gazetë dhe vetëm 0.5% në revistë). Pjesa tjetër e të anketuarve janë të punësuar në në organizata të shoqërisë civile, të vetëpunësuar (freelance) ose në radio.

## 4. Respektimi i të drejtave të gazetarëve në vendin e punës

### 4.1 Informaliteti në punë

A punoni bazuar mbi një kontratë të rregullt pune?

202 responses



80.7% e të anketuarve pohuan se punojnë bazuar në një kontratë të rregullt pune, ndërsa pjesa tjetër prej 19.3% deklaruan se nuk kanë një kontratë të rregullt pune apo nuk kanë informacion për marrëdhënien e tyre kontraktuale. Këto shifra tregojnë një përkeqësim të marrëdhënieve kontraktuale të punës me punëdhënësin në raport me vitin 2021 ku reflektohet një rënie me 3.3% të punonjësve të medias, të cilët punojnë bazuar në një kontratë të rregullt pune.

Kontrata juaj e punës është:

202 responses



Lidhur me kohëzgjatjen e kontratës, 55.5% e të anketuarve u përgjigjën se kanë një kontratë pune pa afat, një shifër që ka pësuar rritje në raport me vitin 2021, kur 42.5% e punonjësve të anketuar deklarorin se kishin kontrata pa afat.


22.3% e të anketuarve u përgjigjën se kanë kontratë me afat 1-vjeçar, ndërkohë që 9.9% deklaruan se nuk disponojnë fare një dokument të tillë. Numri i punonjësve të medias që deklarorin se punojnë pa kontratë ka pësuar rritje 3.9%, në krahasim me vitin 2021 kur këtë e deklarorin 6% e të anketuarve. Këto të dhëna tregojnë se në sektorin e medias kemi përkeqësim në drejtim të informalitetit.

Vlen të theksohet se 7.4 % e të anketuarve deklarojnë se nuk janë në dijeni të kohëzgjatjes së kontratës së tyre. Kjo shifër mund të jetë tregues i një fenomeni shqetësues në media, që ndonëse punonjësit firmosin dokumentin, nuk njihen me përmbajtjen e plotë të të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga kontrata, që nisur nga ky indikator mund të mos iu vihet në dispozicion një kopje e saj, sikurse parashikon legjislacioni në fuqi. Gjithsesi, kjo shifër është në përmirësim në raport me vitin 2021, duke sugjeruar një rritje të ndërgjegjësimit të punonjësve të medias për të patur një kopje të kontratës së punës.

Mosdeklarimi i pagës reale pranë organeve tatimore prek edhe sektorin e medias, ku gati 18% e të anketuarve kanë deklaruar faktin shqetësues se nuk e marrin të plotë pagën në bankë, çka përbën shkelje të nenit 118 të Kodit të Punës. Megjithatë vërehet një përmirësim i situatës në raport me vitin 2021 me një ulje prej 3.5% të punonjësve të medias që pohojnë se një pjesë të pagës e marrin “në dorë”.

A e merrni të plotë pagën tuaj në bankë?

202 responses



Mosdeklarimi i pagës së plotë ka një efekt të dyfishtë negativ si për individin ashtu edhe për institucionet shqiptare. Përveç shmangies së detyrimeve tatimore si dhe pagesave të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, e cila përbën shkelje flagrante të legjislacionit në fuqi<sup>13</sup>, ndikon negativisht edhe në përfitimet direkte afatshkurtra dhe afatgjata për punonjësit e medias, si reduktimi i të ardhurave në rast barrë lindje, paaftësie nga sëmundjet apo mospërfitimin e plotë të pensionin të pleqërisë<sup>14</sup>, duke qënë se këto pagesa bëhen mbi bazën e pagës së deklaruar të punonjësit<sup>15</sup>.

#### 4.2 E drejta për pushime javore dhe vjetore

Edhe kur bëhet fjalë për pushimet javore dhe vjetore të garantuara nga Kodi i Punës, evidentohet se shumica e punonjësve të medias punojnë mbi normën e lejuar përgjatë një jave kalendarike, ne mungesë të pushimeve të mjaftueshme gjatë saj. Konkretisht, 56.4 % e të anketuarve deklarojnë se punojnë 6 ditë në javë, me një ulje prej 7.1 % në krahasim me vitin 2021, ndërkohë që 11.5% e të anketuarve deklarojnë se nuk bëjnë asnjë ditë pushim, indikator i cili ka pësuarë ulje me 3% në krahasim me vitin 2021.

Edhe në Barometrin 2022 – 2023, për punonjësit që kanë 10-15 vjet përvojë në punë vihet re një raportim i lartë i të punuarit përgjatë 7 ditëve të javë, çka tregon se shkelja e të drejtave të përcaktuara në Kodin e Punës nuk bën diferencim mes punonjësve të rinj dhe të vjetër.

<sup>13</sup> 20 Ligji Nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, Ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në RSH”, të ndryshuar dhe neni 117 i Kodit të Punës

<sup>14</sup> Ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

<sup>15</sup> Neni nr. 26; 27; 28; 29, i ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

Të dhënat gjithashtu tregojnë një rritje me 7.7% të numrit të punonjësve të medias që punojnë 5 ditë në javë, në krahasim me Barometrin 2021. Më konkretisht, 27.7% e të anketuarve deklaruan se punojnë 5 ditë në javë.

Shkeljet lidhur me pushimet reflektohen edhe sa i takon pushimeve vjetore, të cilat sipas “Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë” “duhet të zgjasin jo më pak se 4 javë kalendarike gjatë vitit të punës në vazhdim”<sup>16</sup>. Por, 46% e punonjësve deklaruan se bëjnë më pak pushime vjetore, por megjithatë duke reflektuar një përmirësim prej 20% të respektimit të kësaj të drejte. 37.1% e të pyeturve deklaruan se bëjnë 11-15 ditë pushim në vit, ndërsa 2% e tyre deklaruan se bëjnë 6 - 10 ditë pushime në vit. Shqetësues është fakti se 6.9% deklaruan se nuk bëjnë fare pushime vjetore, me një rritje prej 4% në raport me vitin 2021. Të dhënat tregojnë se vetëm 54% e punonjësve gëzojnë efektivisht të drejtat për pushime vjetore në punë.


### 4.3 Bullizimi/tallja në vendin e punës

Rreth 14.5% e të anketuarve pohuan se ishin bullizuar/tallur gjatë punës apo për shkak të saj, në ambientin e punës, një e dhënë që ka pësuar rritje me 2% në raport me vitin 2021. Nga 29 persona që pohuan bullizimin, 6 prej tyre kishin më shumë se 15 vite në punë. Të anketuarit referojnë se autorë të sjelljeve bullizuese apo tallëse janë eprorët e tyre, në nivele të ndryshme duke nisur nga kryeredaktorët, deri te drejtuesit e medias. Në Barometrin 2022 - 2023 të anketuarit referuan bullizime edhe nga kolegët<sup>17</sup>.

A jeni ndjerë ndonjëherë i bullizuar/tallur në ambientin e punës?

202 responses

[Copy chart](#)



Të anketuarit referuan disa shkaqe për të cilat janë ndjerë të bullizuar apo të tallur. Kështu, punonjësit referuan arsye si gjinia, mosha apo veshja dhe pamja e jashtme<sup>18</sup>.

### 4.4 Ngacmimet seksuale në vendin e punës


<sup>16</sup> Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar

<sup>17</sup> Një gazetar referoi talljen për shkak se nuk vlerësohen më gazetarët këmbëngulës dhe profesionistë.

<sup>18</sup> Një gazetar referoi se i është komentuar veshja në punë dhe se komentet ishin bërë nga kolegët/shefet e gjinisw femwr.

Numri i të anketuarve që pohuan se ishin ngacmuar seksualisht në vendin e punës u rrit në këtë Barometër. Nga 202 të pyetur 12, 59%, pranuan të ishin ngacmuar seksualisht. Të anketuarit që pohuan ngacmime seksuale ishin kryesisht femra, por në rubrikën e dëshmimeve pati të anketuar që bënë me dije për ngacmime seksuale edhe ndaj meshkujve në redaksi të ndryshme. Rastet e ngacmimeve seksuale u referuan për të dy vitet e përfshira në anketë. Megjithatë një pjesë e të pyeturve referuan se ngjarjet kishin ndodhur më herët. Të anketuarit thanë se ishin përballur me komente mbi veshjen apo se kishin marrë mesazhe jo të përshtatshme<sup>19</sup>.

A jeni ngacmuar ndonjëherë seksualisht nga dikush, nga i cili keni pasur varësi profesionale në ambientin e punës?  
202 responses



#### 4.5 Nevoja për krijimin e Sindikatës së Punonjësve të Medias

Numri i gazetarëve e punonjësve të medias që mendojnë se krijimi i një sindikate është i nevojshëm për të zgjidhur një mori problemesh ka rënë ndjeshëm nga barometri i fundit. Edhe pse Kodi i Punës të RSH-së në nenit 176 të tij parashikon organizim në sindikata të punëmarrësve dhe punëdhënësve, për vite me rradhë një organizim i punonjësve të medias ka dështuar.<sup>20</sup>

Nga 202 të anketuar, 89% e tyre pohojnë nevojën për krijimin e një sindikate me qëllim mbrojtjen e të drejtave të tyre në punë, kjo shifër ka qënë 97% në barometrin e vitit 2021. Numri i punonjësve të medias që nuk janë në favor të një sindikate është rritur në 5.4% dhe po aq është numri i atyre që janë të pasigurtë nëse sindikata do të ndikonte në gjendjen e punonjësve të medias në vend.


Ndërkohë edhe numri i të pyeturve që janë dakord të marrin pjesë në një sindikatë ra në dy vitet e fundit. 29.1 % e të pyeturve u shprehën se nuk do ishin pjesë ose e vunë në dyshim pjesëmarrjen, ky numër në barometrin e fundit ishte vetëm 10.5%. Të anketuarit fajësuan për mos organizimin, mungesën e solidaritetit në 59.9% të përgjigjeve, por 25.2% arsyetojnë se ka një presion nga pronarë të mediave që nuk lejon krijimin e kësaj organizate. Në disa nga përgjigjet specifike të pyeturit referojnë se një Sindikatë për

<sup>19</sup> Një prej të anketuarve referoi se kishte marrë mesazhe me konotacion seksual.

<sup>20</sup> Elementët që duhet të mbajë statuti i tyre, kufirin minimal të anëtarëve themelues të tyre (përkatësisht jo më pak se 20 anëtarë për sindikatat), fitimin e personalitetit juridik pasi organizata të ketë depozituar aktin e themelimit dhe statutin në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, parimet që udhëheqin këto organizata, ku ndër më të rëndësishmit është se zgjidhja e kontratës së punës, nga punëdhënësi, për përfaqësuesit e organizatës sindikale, pa pëlqimin e kësaj organizate, është e pavlefshme, etj.

Gazetarët dhe Punonjësit e Medias ishte krijuar tashmë. Megjithatë fakti që shumica dërrmuese e të pyeturve nuk kanë dijeni për këtë organizim tregon së paku që përfshirja është e ulët.

A është e nevojshme që gazetarët të kenë një sindikatë që do të mbronte të drejtat e tyre në punë?  
202 responses




## 5. Liria profesionale

### 5.1 Kërcënimet për shkak të punës

Gjatë viteve 2022 dhe 2023 janë raportuar një sërë rastesh të sulmeve ndaj gazetarëve apo punonjësve të medias të goditur fizikisht dhe të kërcënuar publikisht për shkak të detyrës. Rastet më të rënda përfshijnë sulmin me armë me pasojë vrasjen e rojës së Top-Channel, sulmin ndaj gazetarit Elvis Hila dhe bashkëshortes së tij<sup>21</sup>, kërcënimin e gazetarëve të Fiks-Fare<sup>22</sup> në Krujë dhe një sërë rastesh të ngjashme<sup>23</sup>.

A jeni ndjerë ndonjëherë i kërcënuar fizikisht si pasojë e punës tuaj gjatë periudhës 2022 - 2023?  
202 responses



Por përtej rasteve të njohura të anketuarit në barometër dëshmojnë për një situatë të vazhdueshme presioni, kërcënimin dhe sulmesh. Të pyeturit raportojnë se janë përballur me vizita në redaksi, presione përmes telefonatave apo takimeve direkte dhe kërcënimeve se do të humbisnin vendin e punës<sup>24</sup>. Kërcënimet siç del nga përgjigjet në pyetësorë nuk kanë kursyer as familjet e punonjësve të mediave.<sup>25</sup>

Një situatë e tillë dëshmon se një pjesë e gazetarëve dhe punonjësve të medias janë nën presion që i kushtëzon dhe i shtyn drejt vetëcensurimit. Të anketuarit identifikojnë si kërcënues shpesh përfaqësues të lartë të politikës, zyrtarë të lartë dhe pjesëtarë të krimit të organizuar. Autoritetet shtetërore, si Policia e

<sup>21</sup><https://shqiptarja.com/lajm/dhunohet-per-shkak-te-detyres-gazetari-i-report-tv-elvis-hila-ne-lezhe-dhe-bashkeshortja-e-tij>

<sup>22</sup> <https://www.reporter.al/2023/02/10/tre-persona-u-shpallen-ne-kerkim-nga-policia-per-sulmin-ndaj-gazetareve-te-fiks-fare/>

<sup>23</sup> <https://www.reporter.al/2023/07/17/zhdokuni-nga-ketu-gazetarja-e-syri-perballet-me-presion-ne-rrogzhine/>

<sup>24</sup> Një i anketuar shkruan se e kanë kërcënuar se do e largonin nga puna “nëse nuk heq dorë nga një çështje që po ndiqja”.

<sup>25</sup> Një gazetar shkruan: Jam ndier në disa raste, gjë që ka ndikuar dhe në mënyrën se si unë punoj, duke më stepur. Në një rast kërcënimin erdhi tek unë përmes familjarëve të mi.

Shtetit, Garda e Republikës vijojnë të përmenden si penguese në punën e gazetarëve, sidomos në raportimet e ngjarjeve apo protestave publike. Po ashtu sulme verbale dhe fizike ndaj gazetarëve ka edhe prej personave që përmenden në raportime.


Megjithatë të dhënat e Barometrit për vitet 2022-2023 tregojnë një rënie të kërcënimeve fizike, nga 34.5 % në anketën e vitit 2021 në 20.3% në këtë anketë të fundit. Por rastet e njohura botërisht kanë qenë më të rënda dhe përfshijnë për herë të parë një viktimitë sikurse u shënuar në Median e Top Channel dhe shumica e tyre vijojnë të mbeten të pazbardhura.

Ngjashmërisht ka një rënie me mbi 20 për qind të të anketuarve që deklarojnë se janë kërcënuar apo që u është bërë presion verbal. Nga 52.5% e të anketuarve në vitin 2021 në 31.2% në dy vitet 2022 dhe 2023.

Të anketuarit fajësojnë në shumicë politikën sa i përket presioneve verbale. “Në disa raste persona me pozitë politike për shkak të artikujve apo publikimeve të mia”, thotë një prej të pyeturve. Në vitin 2023 u shënuar rasti i një fushate me natyrë denigruese ndaj një gazetaresje, për të cilën organizatat e medias reagues publikisht<sup>26</sup>.


Të pyetur nëse kanë mbështetje nga punëdhënësit nëse gjenden në situata të tilla vetëm 40% e të anketuarave janë përgjigjur pozitivisht me një rënie prej 10% nga Barometri i vitit 2021. Megjithatë numri i punonjësve të medias që deklarojnë se nuk kanë mbështetje është i njëjtë 24%, ndërsa është rritur numri i atyre që janë të paqartë për reagimin e punëdhënësit dhe janë shprehur se nuk e dinë.

A jeni ndjerë i mbështetur nga punëdhënësi juaj në rastet e kërcënimit si pasojë e punës tuaj?  
202 responses



## 5.2 Stresi dhe situatat traumatike

A keni përjetuar ndonjëherë nivel të lartë stresi si pasojë e punës?  
202 responses



Gazetarët dhe punonjësit e medias kanë një punë, e cila kërkon përballimin e një presioni të jashtëzakonshëm. Kjo përfshin përballimin e sulmeve verbale e fizike, kërcënimet, por edhe raportimin e temave të ndjeshme. Për këto arsye e të tjera, gazetaria konsiderohet një prej profesioneve më stresuese. Kjo konfirmohet edhe nga përgjigjet e mbledhura në anketë. Konkretisht, 81.2% e të pyeturve u përgjigjen se kishin përjetuar nivele të larta stresi në punë. Shifra është e ngjashme me nivelet e stresit të raportuara në studime të ngjashme në rajon<sup>27</sup>, megjithatë ka një përmirësim prej 5.8% krahasur me Barometrin 2021.

<sup>26</sup> <https://www.reporter.al/2024/03/07/organizatat-e-medias-ndal-fushates-se-shpifjeve-ndaj-gazetares-ola-xama/>

<sup>27</sup> <https://www.osce.org/files/f/documents/a/2/545761.pdf>




Një rënie të ngjashme ka edhe sa i përket mbulimit apo raportimit të ngjarjeve me pasojë tronditje të fortë psikologjike. 62.4% e të pyeturve thanë se kishin marrë pjesë në raportime tronditëse, 5.6% më pak se sa në Barometrin tonë të fundit. Të dhënat e mbledhura tregojnë se shumica e këtyre raportimeve kanë ndodhur herët në karrierë, por 46% e të anketuarve thanë se kishin raportuar apo mbuluar histori që i kishin tronditur në dy vitet e fundit.

Njëlloj si në barometrat e kaluar, shumica dërrmuese e gazetarëve referuan se nuk kërkojnë ndihmë mjekësore për stresin apo për tronditjen. Megjithatë numri i të pyeturve që kishin kërkuar ndihmë u dyfishua nga Barometri 2021, nga 6% në 12%. Kjo e dhënë tregon një kujdes më të shtuar të gazetarëve për shëndetin e tyre psiko-emocional.

Po ashtu, të pyetur nëse kishin kërkuar ndihmë nga ana e organizatave që mbrojnë të drejtat e mediave dhe gazetarëve për ndonjë situatë të pakëndshme që lidhet me punën, shumica e të anketuarve u përgjigjën negativisht. Ndërkohë, rreth 14% e të pyeturve, 28 persona, u përgjigjën se kishin kërkuar dhe gjetur ndihmë për çështje të ndryshme prej një numri organizatash përfshi Komitetin Shqiptar të Helsinkit, Safe Journalists, Civil Rights Defenders e të ngjashme.

### 5.3 Censura dhe vetëcensura


A ju ka ndodhur që punëdhënësi t'ju ketë ndaluar direkt apo përmes eprorit tuaj të publikoni një lajm?  
202 responses



Nga përgjigjet e mbledhura prej anketës, numri i rasteve të censurës dhe vetë censurës në vitet 2022 dhe 2023 ka rënë, në krahasim me dy pyetësorët e kaluar. Konkretisht, 50.5% e të pyeturve thanë se ishin censuruar, por 31% (68 të pyetur) raportuan që kjo kishte ndodhur në vitet 2022-23, ndërsa pjesa tjetër u referua viteve të mëparshme.

Ajo që bie në sy është se ata që raportojnë censurë vënë në dukje se ajo është e përsëritur dhe shpesh është e lidhur apo është në favor të një entiteti publik të afërt me median ku ndodh censura. “Raste që lidhen me

Nëse po, kur ka ndodhur kjo?  
103 responses



ministri të caktuara, për të cilën media ku punoj nuk lejon të publikohen lajme kundër”, thotë një prej të anketuarve. Të tjerë referojnë emra të posaçëm ministrash apo figurash politike apo persona të lidhur me botuesin, pronarin e medias. “Kur kanë qenë kundra qeverisë dhe interesave të pronarëve”, thotë një nga të anketuarit.

Ndërkohë, 78 të anketuar raportuan se u ishte kërkuar të linin përgjysëm një hulumtim.

Arsyet për të ndërprerë raportimin mbi një çështje rezultojnë të ngjashme me ato që përmenden në rastet e censurës. Të pyeturit referojnë kryesisht ndërhyrje në raste të çështjeve që lidhen me biznese të botuesit, institucionet apo politikanë. Çështjet e përmendura më shpesh kanë të bëjnë me Ministrinë e Infrastrukturës, Bashkinë e Tiranës, qeverinë në tërësi, ndërsa në dy raste të anketuarit thanë se u ishte ndaluar vijimi i punës për raportime në lidhje me ndryshimin e ligjit për zonat e mbrojtura.


5 % e të pyeturve pranuan se kishin marrë kërkesa për të raportuar lajme të rreme dhe 8.4% u përgjigjën se nuk e dinin nëse kishin marrë një kërkesë të tillë në dy vitet e fundit. Shumica dërrmuese e të pyeturve thanë se kjo kishte ndodhur më herët se periudha 2022-2023. Trendi është i ngjashëm me atë në Barometrat e mëparshëm.

Vetë-censura duket se vijon të jetë një nga problemet kryesore sa i përket lirisë së medias në vend. 47 % e të pyeturve pranuan se ishin vetëcensuruar, nga frika se lajmi nuk do i pëlqente botuesit apo redaktorit. 10% e të pyeturve ishin të pasigurt nëse kjo kishte ndodhur.

Rreth 60 nga të pyeturit vunë në dukje se vetëcensurimi kishte ndodhur në dy vitet e fundit. Një pjesë e mirë e këtij grupi, 44 të anketuar, thanë se kjo kishte ndodhur edhe në vitin 2022 edhe në vitin 2023 duke dëshmuar një trend të qëndrueshëm.

A ju ka ndodhur që të keni shmangur raportimin e një lajmi sepse keni menduar se publikimi i tij nuk do t'i pëlqejë punëdhënësit/redaktorit tuaj?


202 responses



Gati gjysma e të pyeturve në anketë janë të pasigurt nëse do të mund të mbanin vendin e punës pasi të kishin publikuar apo ndihmuar në publikimin e një lajmi që mund të mos pëlqejë nga punëdhënësi apo eprori. 45.5% e të pyeturve u përgjigjën se nuk e dinin nëse publikimi mund të sillte shkarkim nga puna ose ishin të bindur që kjo do të ndodhte. 25.2% e të pyeturve ishin të bindur se nëse shkonin kundra pëlqimeve të punëdhënësit do e humbisnin vendin e punës.

A keni frikë se publikimi i një lajmi, që mund të mos i pëlqejë punëdhënësit/eprorit tuaj, mund t'ju pushojë nga puna?

202 responses




Ndërkohë paditë ndaj gazetarëve në gjykata nuk i qëndrojnë testimit në gjykatë në shumicën e tyre dhe duken më shumë si padi SLAPP<sup>28</sup>, njohur ndryshe si përpjekje për t'i trembur gazetarët. Numri i gazetarëve që deklarojnë se frikësohen nga një padi në gjykatë është më i vogël se i atyre që tremben të humbasin vendin e punës për shkak të mosbindjes ndaj botuesit. Vetëm 27.3 % e të anketuarve u përgjigjën në pyetësor se i trembeshin një padie në gjykatë.

<sup>28</sup> <https://www.ecpmf.eu/engage/slapp/>

Bazuar në përgjigjet e mbledhura, vihet re se frika e humbjes së vendit të punës luan një rol të madh në mënyrën se si gazetarët raportojnë. Të pyetur për të shkallëzuar se sa ndikonte kjo në punën e tyre, ku 1 ishte pa ndikim dhe 5 shumë ndikim, 47.1 për qind e të anketuarve u përgjigjën nga 3-5. Të dhënat janë të përafërta me ato në pyetjen pararendëse mbi frikën se botuesi apo eprori do i shkarkonin nga puna nëse raportimi nuk do ishte i pëlqyeshëm. Kjo dëshmon pasigurinë në lidhje me kontratat e punës dhe lirinë profesionale të gazetarit.

Në një shkallë nga 1 (Pa ndikim) te 5 (Shumë ndikim) sa ndikon në raportimin tuaj frika se mund të humbisni vendin e punës?  
202 responses



## 6. Vlerësimi i lirisë së medias

Të dhënat e mbledhura tregojnë se ndërsa gazetarët e shohin vetën e tyre të lirë, mendimi për median dhe lirinë e saj në përgjithësi mbetet mjaft negativ dhe është përkeqësuar ndjeshëm nga Barometrat e viteve 2020 dhe 2021.


Ndërkohë faktorët që çënojnë lirinë e medias dhe incidentet që sipas të pyeturve kanë ndikuar në përkeqësimin e këtij perceptimi mbeten të ngjashëm me ato në vitet e kaluara. Sulmet verbale të funksionarëve të lartë publikë dhe politikanëve përmenden më shpesh si faktorë të çënimit të lirisë në të dy vitet e përfshira në anketë.

Ngjarje si atentati pranë Top-Channel, kontrolli i ushtruar nga SPAK ndaj gazetarit Elton Qyno, sulmi fizik ndaj gazetarit Elvis Hila, shkarkimet nga puna në televizionin publik dhe një sërë ngjarjesh të ngjashme veçohen nga të pyetur si arsye për rënien e lirisë së medias në vend.


Të pyeturit masivisht vlerësojnë se përgatitja më e mirë profesionale e gazetarëve dhe mbështetje e tyre me fonde të pavarura nga pusheti apo biznesi në vend do të përmirësonin cilësinë dhe lirinë e medias.

### 6.1 Perceptimi mbi lirinë e medias dhe tendenca

Sa të lirë e vlerësoni median në Shqipëri në vitin 2022?  
202 responses



Sa të lirë e vlerësoni median në Shqipëri në vitin 2023?  
202 responses



Të pyetur veç e veç për vitet 2022 dhe 2023, të anketuarit në masën 81.2% për vitin 2022 dhe 80.6% për vitin 2023 vlerësuan se media në Shqipëri ishte pak ose aspak e lirë. Por nëse dy vitet duken përafërsisht njëjloj, numri i atyre që besojnë se media në vend është aspak e lirë u rrit 4 për qind në vitin 2023.

Ajo që bie në sy është rënia me rreth 13% e atyre që besonin në vitin 2021 se media ishte “mesatarisht e lirë”. Nga 28% që ka qenë në atë barometër, numri ra në 15.3% në vitin 2022 dhe ishte 15.8% në vitin 2023. Siç del nga anketa këta persona tashmë kanë një perceptim më të keq për median. Duke marrë parasysh që në pyetësor marrin pjesë një grup i ngjashëm personash, kjo mund të interpretohet si një përkeqësim në vijim i perceptimit mbi lirinë e medias në vend.

Vetëm një numër minimal prej 7 të pyeturish (3.5%) vlerësuan pozitivisht gjendjen e medias në vend, si të e lirë apo plotësisht e lirë. Kjo nuk ka ndryshuar shumë nga Barometri i vitit 2021, kur numri i të pyeturve në këto dy kategori ishte 8.

Në përgjigje të një pyetje me shumë zgjedhje, për të kuptuar se si ishte krijuar perceptimi mbi lirinë e medias, shumica dërrmuese e të pyeturve, 71.3% thonë se vlerësimi i tyre vjen së pari nga eksperiencia personale, së dyti vlerësimi bazohet mbi përvojat e kolegëve që është zgjedhur si alternativë nga 48.5 %. Të anketuarit po ashtu thonë se ndikohen nga raportet mediatike në vend dhe më pak vetëm 29.7 % thonë se i referohen raporteve ndërkombëtare.

## **6.2 Ngjarjet (faktorët) ndikues**

Të pyetur, në një pyetje me shumë alternativa, për të renditur arsyet kryesore të mungesës së lirisë apo arsyeve pse besojnë se media nuk është e lirë, shumica e të anketuarve zgjedhën si arsye kryesore ndërhyrjet dhe interesat e biznesit 78.7%, së dyti u përzgjedh ndërhyrja e qeverisë 71.8 % dhe si arsye e tretë e përzgjedhur ishin ndërhyrjet e partive politike me 40.1%.

Krimi i organizuar dhe bizneset që reklamojnë u zgjedhën si faktorë ndikues nga 28.2% dhe 27.7% e të pyeturve. Të dhënat e mbledhura u ngjajnë atyre të barometrit të shkuar, megjithatë duket se ndërhyrjet e qeverisë dhe ndikimi i biznesve që kanë në pronësi media kanë ndryshuar vendet si faktorët më shumë të përzgjedhur.

Por kur vjen puna për të listuar ngjarje që kanë cënuar lirinë apo kanë dëshmuar se media është nën presion shumica dërrmuese e atyre që u përgjigjën veçuan sulmet e politikanëve ndaj medias. Përballja e gazetarëve me kryeministrin në konferenca shtypi dhe termi i përdorur prej tij për “riedukim” që u përdor për të ndaluar pjesëmarrje të disa reporterëve në konferenca shtypi në vitet 2022 dhe 2023 u përmend 10 herë si ngjarje specifike, ndërsa 17 herë u përmend kryeministri dhe fjalori i përdorur prej tij ndaj gazetarëve.

Atentati që i mori jetën rojës në Top-Channel dhe goditjet fizike ndaj gazetarëve po ashtu u vunë në dukje si faktorë ndikues. Disa nga gazetarët përmenden edhe situatat e krijuara mes institucioneve shtetërore dhe medias, duke referua prishjen e një biznesi të botuesit të Panorama e News 24, apo problemet ligjore të Ora News. “Sulmet verbale dhe fizike ndaj gazetarëve, shpifjet dhe padite”, thuhet në një nga përgjigjet.

Një pjesë e të pyeturve thanë se gjendeshin në presion të vazhdueshëm dhe se çdo përpjekje për censurë ishte arsye për perceptimin e tyre negativ mbi lirinë e medias në vend. “Censura e përditshme vlen sa të gjitha ngjarjet së bashku”, tha një prej të anketuarve.

Të anketuarit në shumicë dërrmuese e kishin të pamundur të gjenin në dy vite ngjarje që mund të çonin në përmirësim të lirisë. Shumica këtu u përgjigj me “nuk e di” apo “nuk ka”. Një numër i vogël të anketuarish veçuan reformën në drejtësi dhe arrestimin e disa politikanëve apo theksuan guximin personal të gazetarëve.


### 6.3 Gazetaria Cilësore

Krahasimisht me vitin 2021 të anketuarit pohuan se në vend kishte më pak gazetari cilësore. Nga 30% që besonin atëherë se gazetaria cilësore ishte prezentë dhe në rritje, numrat ranë në 19.3% për vitin 2023, ndërsa si vlerësim për vitin 2022 pohimet për prani të gazetarisë cilësore ishin në masën 16.9%.

Ndërkohë perceptimi se gazetaria cilësore mungonte u rrit nga 30.5% në vitin 2021, në 43.6% në vitin 2022 dhe 39.6% në vitin 2023. Ashtu si në perceptimin për lirinë e medias numri i të anketuarve që besonte në një gjendje të pandryshuar është ulur dhe në shumicë të anketuarit që i përkisnin këtij grupi anojnë nga përkeqësimi i situatës.

Në pyetjet e hapura mbi idetë e tyre se si në vend mund të kishte gazetari cilësore, një pjesë e mirë e të pyeturve thonë se shkollimi më i mirë i gazetarëve dhe përgatitja e tyre më e mirë profesionale do të ndikonte pozitivisht.

Të pyeturit po ashtu theksuan nevojën për pavarësi më të madhe financiare të mediave dhe kishte prej tyre që vlerësuan se një vetërregullim i gazetarëve do të ndihmonte në përmirësimin e cilësisë së raportimit. Të renditura sipas përzgjedhjeve të të anketuarve, krijimi i një sindikate që merr në mbrojtje gazetarët kishte përkrahjen më të madhe me 59.9% që e zgjedhën si zgjedhje të parë që do ndikonte në përmirësimin e lirisë, 55% zgjedhën formimin profesional dhe 53% mbështetjen financiare nga donatorë të huaj jashtë ndikimit të politikës dhe biznesit vendas.



### 6.4 Aksesimi në Gjykatë

Njësoj si në barometrin e vitit 2021, në shumicë dërrmuese, gazetarët thanë se nuk i drejtoheshin gjykatës, për të mbrojtur lirinë e tyre apo vendin e punës, për shkak të burokracive. 64.4% e të pyeturve zgjedhën këtë si arsye të parë për mungesë të betejave ligjore. Arsye të tjera për të mos iu drejtuar gjykatës pa ndryshime të mëdha nga viti 2021, evidentohen hakamarrja e punëdhënësit në masën 56.9%, dhe frika se nuk do mund të gjenin punë në një vend tjetër në masën 57.9%.

## 7. Rekomandime

Sipas të dhënave të anketës, organizimi sindikal përbën një aspekt të rëndësishëm për mbrojtjen e gazetarëve dhe sigurinë e tyre në punë, megjithë rënien e numrit të atyre që e shohin këtë të mundur.

Të anketuarit nënvizojnë gjithashtu rëndësinë e zhvillimit të tyre profesional, përmirësimin e kushteve të punës dhe shpërblimin financiar – të gjitha faktorë që ndikojnë pozitivisht në cilësinë e medias në vend. Donacionet e huaja shihen si një ndihmesë e rëndësishme për pavarësinë e medias nga politika.

Kërkesat për përmirësime janë të ngjashme me ato të viteve të shkuara, duke reflektuar ndryshime minimale në përgjigjet e anketës dhe po ashtu një përkeqësim të perceptimit mbi lirinë e medias. Bazuar në të dhënat e anketës dhe përgjigjet e marra në pyetjet e hapura, Komiteti Shqiptar i Helsinkit mbështet rekomandimet si më poshtë:

### *7.1 Rekomandime për Organizatat e Shoqërisë Civile Vendase dhe Ndërkombëtare*

Ofrimi dhe rritja e mbështetjes me trajnime që mundësojnë zhvillim profesional të punonjësve në sektorin e medias si dhe përkrahja e dëshirës së shumicës dërrmuese të gazetarëve dhe punonjësve të medias për një organizim sa më të fuqishëm sindikal. Këto dy rekomandime, si kërkesa që përsëriten më shpesh nga të anketuarit, kanë nevojë të adresohen me zgjidhje konkrete.

Përpjekjet e vazhdueshme pa sukses apo të përmendurit shpesh pa ndonjë angazhim konkret e kanë ulur besimin se organizimi sindikal do kishte efekt në gjendjen e medias në vend, megjithatë edhe në këtë anketë ky organizim mbetet në listën e gjërave që shumica e të anketuarve do donin të realizohej. Sindikalizmi dhe pjesëmarrja masive në sindikata do të ofronte mbrojtje nga praktiket e abuzimit në vendin e punës, shkarkimet e padrejta nga puna dhe mund të shërbente si një mbrojtje ndaj presioneve të politikës e faktorëve të tjerë.

Ndërkohë nxitja e profesionalizmit dhe zgjerimi i mundësive për zhvillim profesional mbeten të domosdoshme, qoftë për të pasur më shumë liri, qoftë edhe për të mundësuar një mjedis mediatik më të shëndetshëm. Në këtë pikë duhet të mbahen parasysh disa rekomandime:

- 1) Mbështetja apo nxitja e nismave vetërregulluese, që mund të kontribuojnë pozitivisht në forcimin e pavarësisë, integritetit, etikës dhe profesionalizmit të medias në vend.
- 2) Informimi dhe edukimi i vazhdueshëm i punonjësve të medias mbi të drejtat dhe liritë e tyre profesionale, si dhe nxitja dhe mbështetja për t'u përgjigjur në mënyrë të organizuar ndaj krizave dhe sulmeve që çenojnë lirinë e medias, duke përfshirë këtu marrëdhëniet ligjore të punës si dhe paditë e ashtëquajtura "SLAPP"
- 3) Përfshirja e vazhdueshme e përfaqësuesve të shoqërisë civile vendase dhe ndërkombëtare për të ndihmuar në krijimin e një mjedisi më të sigurt pune për gazetarët dhe punonjësit e medias, është një faktor thelbësor që mbështet dhe forcon lirinë e medias.
- 4) Sigurimi i shërbimeve ligjore cilësore dhe profesionale, pa pagesë dhe mbështetja profesionale në rastet e shkeljeve të të drejtave të punonjësve në sektorin e medias duke përmirësuar qasjen e tyre në sistemin e drejtësisë, do të krijonte praktika pozitive për mbrojtjen e lirisë së shprehjes në gjykata. Në shumë raste, ndonëse ekzistojë programe për ofrimin e shërbimeve ligjore falas, ato nuk njihen nga punonjësit e medias, ndaj rekomandohen fushata promovuese më të fuqishme (përfshi këtu edhe

organizatat që e ofrojnë këtë shërbim), në mënyrë që informacioni të arrijë në sa më shumë punonjës të këtij sektori.

### ***7.2 Rekomandime për gazetarët***

Pjesëmarrja në aktivitete apo trajnime që kanë në fokus rritjen e informacionit mbi të drejtat e gazetarëve në vendin e punës. Kjo ndihmon në rritjen e ndërgjegjësimit mbi të drejtat në vendin e punës e për pasojë edhe ndjekjen e hapave të duhur ligjorë për arritjen e tyre.

Fuqizimi i organizimit të sindikal të punonjësve të medias që është krijuar në vitin 2024, çka kërkon më së pari mbështetje, anëtarësim dhe solidaritet nga vetë punonjësit e medias dhe gazetarët. Por anëtarësia në një sindikatë nuk nënkupton domosdoshmërisht një pjesëmarrje aktive dhe publike, ndërkohë që legjislacioni shqiptar garanton angazhimin e punonjësve në sindikata.

Ndjekja në rrugë gjyqësore e shkeljeve të bëra nga punëdhënësi në marrëdhëniet e punës si dhe marrja e mbrojtjes së specializuar ligjore falas në rastet e padive “SLAPP” ndaj tyre. Pavarësisht se kjo formë konceptohet nga punonjësit e medias si e vështirë dhe me shumë barriera, tashmë ekzistojnë shumë raste, që tregojnë suksesin e arritur.

### ***7.3 Rekomandime për përfaqësuesit e organeve publike dhe partive politike***

Roli i politikës dhe sidomos ai i politikanëve në pushtet është gjetur si një prej faktorëve kryesorë në përkeqësimin e lirisë së medias dhe situatën e këtij sektori, duke i cilësuar si një prej censorëve dhe sulmuesve verbalë më të pranishëm. Në këtë rast për politikën ka një listë të përsëritur rekomandimesh, pjesa më e madhe e të cilave varet nga vullneti i politikanëve dhe figurave me pushtet:

- i) Të ndalohen dhe të dënohen pa mëdyshje të gjitha sulmet verbale apo fizike ndaj gazetarëve prej figurave politike. Të ndalohet gjuha denigruese dhe t’u krijohen gazetarëve hapësira më praktike për të marrë informacionin.
- ii) Të decentralizohen marrëdhëniet e organeve të ekzekutivit me publikun, të cilat që prej vitit 2021 janë monopolizuar dhe kontrollohen përmes “Agjencisë së Medias dhe Informimit”. Informimi dhe dhënia e mundësisë për gazetarët, prej institucioneve qeveritare, të ndjekin aktivitetet publike të ministrave e drejtuesve të institucioneve, duke krijuar mundësinë e marrjes së një informacioni të pavarur.
- iii) Praktika e videove të gatshme në fushatë, e cila ka vijuar edhe në zgjedhjet e fundit, duhet të ndërpritet. Ndërsa politikanët dhe drejtues të institucioneve e kanë zgjedhjen për të komunikuar me publikun në rrjete sociale e të ngjashme, kjo nuk duhet të sjellë mbyllje të dyerve për median dhe gazetarët.
- iv) Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH), të zbatojë kompetencat e parashikuara në ligj, duke kryer monitorime objektive dhe të paanshme në redaksitë e mediave audiovizive dhe të shkruara, si dhe të marrë masa në rastet e konstatuar në shkelje. Rekomandohet që realizimi i monitorimeve, gjetjet e tyre apo masat administrative të vendosura ndaj punëdhënësve në sektorin e medias të jenë sa më publike, si dhe të gjendet hapësira edhe brenda medias për promovimin e tyre. Një alternativë mund të jetë Radio Televizioni Shqiptar.
- v) Administrata tatimore të kryerjë verifikime në terren, sipas përcaktimeve ligjore, lidhur me regjistrimin e punonjësve. Sikurse përcaktohet edhe në ligj, këto verifikime duhet të kryhen pa

- njoftimin paraprak të personit të tatueshëm, ndërsa për kundërvajtjet administrative tatimore, të evidentuara gjatë verifikimit në terren duhet të merren masat administrative. Sikurse, në rastin e kontrolleve nga ISHPSHSH rekomandohet që këto verifikime dhe konstatimet e kryera të jenë publike.
- vi) Të kryhen monitorime/verifikime të përbashkëta mes administratës tatimore dhe ISHPSHSH-së, duke zbatuar dispozitat ligjore në fuqi, që kërkojnë përpjekje konkrete nga ana e inspektoriateve (si Inspektorati i Punës (ISHPSHSH) dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) dhe agjencive të ngritura me synim monitorimin objektiv, të paanshëm dhe joselektiv si dhe në mënyrë rigoroze të zbatimit të kuadrit ligjor nga ana e entiteteve private dhe atyre publike .
  - vii) Rreziku nga përqendrimi i medias në pak duar vijon të mbetet i lartë në vend dhe është e nevojshme që të rishihet kuadri legjislativ për të ndaluar përqendrim të mëtejshëm dhe ndihmuar pluralizmin në këtë mjedis.
  - viii) Kuvendi i Shqipërisë të luajë një rol proaktiv, në drejtim të mbrojtjes së të drejtave të gazetarëve në vendin e punës dhe veçanërisht, Komisioni parlamentar për Median dhe Mjetet e Informimit Publik, që ka në fushat e përgjegjësisë median e shkruar dhe atë vizive. Rekomandohet zbatimi i kompetencave të parashikuara në Rregulloren e Kuvendit, duke kryer seanca dëgjimore me drejtuesit e institucioneve kontrolluese përgjegjëse të sipërcituara, apo çdo institucion tjetër që mund të ndikojë pozitivisht në respektimin e të drejtave në punë të gazetarëve. Gjithashtu, rekomandohet që, Komisioni të organizojë seanca dëgjimore publike me ekspertë, përfaqësues të shoqërisë civile apo përfaqësues të grupeve të interesit.